



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2019:211140
Datë: 29.03.2024
Numri i dokumentit: 05522859

Ac.nr.4618/20

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Halide Reka, kryetare e kolegjit, Nora Bllaca Dula dhe Ylber Shurdhiqi, anëtarë, në çështjen juridike kontestimore të paditëses Sh.B. nga fshati ..., Komuna e Obiliqit, të cilën sipas autorizimit e përfaqëson B.S, avokat nga Prishtina, kundër të paditurës Kompania e Sigurimeve “K...” në Prishtinë, të cilën sipas autorizimit e përfaqëson V.R, jurist, për kompensimin e dëmit, duke vendosur sipas ankesës së të paditurës, të paraqitur kundër Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë, Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.2912/14 të datës 02.07.2019, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 27.03.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

I. REFUZOHET si e pabazuar ankesa e të paditurës Kompania e Sigurimeve “K...”, në Prishtinë, ndërsa Aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë, Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.2912/14 të datës 02.07.2019 , në pikën I (një) dhe III (tre) të dispozitivit VËRTETOHET.

II. Aktgjykimi i ankimuar në pikën II (dy) të dispozitivit mbetet i pashqyrtuar.

A r s y e t i m

Gjykata e shkallës së parë, me aktgjykimin e ankimuar C.nr.2912/14 të datës 02.07.2019, në pikën I (një) të dispozitivit e ka miratuar pjesërisht kërkesëpadinë e paditëses Sh.B. nga fshati ..., Komuna e Obiliqit dhe e ka detyruar të paditurën Kompania e Sigurimeve “K...” në Prishtinë, që paditëses në emër të kompensimit të dëmit jo material dhe material të pësuar si pasojë e aksidentit të trafikut i cili ka ndodh me dt.12.07.2014, t`ia paguaj dhe atë:

- për dhembje trupore fizike shumë prej 1.500 Euro,
- për frikën e përjetuar shumë prej 1.300 Euro,

- në emër të shpenzimeve të mjekimit shumë prej 65.50 Euro
- në emër të ushqimit të përforcuar shumë prej 300 Euro dhe
- për ndihmën dhe kujdesin e huaj shumë prej 200 Euro
të gjitha me kamatë prej 8%, duke iu llogaritur nga data 02.07.2019 e marrjes së aktgjykimit e deri në paguarjen definitive.

Në pikën II (dy) të dispozitivit e ka refuzuar pjesën tjetër të kërkesëpadisë së paditëses mbi shumat e gjykuara dhe atë: për dhembje trupore fizike mbi shumë prej 1.500 Euro deri në 4.000 Euro, për përjetimin e frikës mbi shumë prej 1.300 Euro deri në 3.000 Euro, si dhe e ka refuzuar në tërësi kërkesën e padisë me të cilën paditësja ka kërkuar që në emër të rehabilitimit fizioterapeutik t'ia paguaj shumë prej 400 Euro.

Në pikën III (tre) e ka detyruar të paditurën Kompania e Sigurimeve "K..." në Prishtinë që paditëses shumat e gjykuara në pikën I të dispozitivit të aktgjykimit si dhe shpenzimet e procedurës në shumë prej 738.40 Euro t'ia paguaj në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes së aktgjykimit në dorëzim nën kërcënim të përmbarimit forcërisht.

Kundër këtij aktgjykimi, në afat ligjor ka paraqitur ankesë e paditura, duke e atakuar të njëjtin për shkak të shkeljes së dispozitave të procedurës kontestimore, konstatimit të gabuar apo jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale me propozim për Gjykatën e Apelit që ankesa të aprovohet si e bazuar aktgjykimi i atakuar të prishet dhe çështja t'i kthehet në rigjykim gjykatës së shkallës së parë ose i njëjti të ndryshohet dhe të gjykohet në shumë e ofruar nga e paditura.

Gjykata e Apelit të Kosovës si gjykatë e shkallës së dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktgjykimin e atakuar dhe komplet shkresave të lëndës, në mbështetje të dispozitës së nenit 194 dhe 195 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), ka gjetur se:

Ankesa e të paditurës është e pa bazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësja me datë 20.10.2014, në gjykatën e shkallës së parë përmes të autorizuarit të saj ka ushtruar padi kundër të paditurës Kompania e Sigurimeve "K..." në Prishtinë, për kompensimin e dëmit sipas autopërgjegjësisë, të shkaktuar në aksidentin e komunikacionit të datës 12.07.2014, me arsyet sikurse në padi.

Gjykata duke vepruar sipas padisë dhe kërkesëpadisë së paditëses, pas shqyrtimit dhe administrimit të provave të paraqitura nga palët ndërgjyqëse si dhe vlerësimit të të gjitha shkresave tjera të lëndës, ka nxjerrë aktgjykimin e atakuar C.nr.2912/14 të datës 02.07.2019, me të cilin e ka aprovuar pjesërisht si të bazuar kërkesëpadinë e paditëses, duke vendosur më decidivisht si në dispozitiv të aktgjykimit të atakuar.

Në arsyetim të aktgjykimit të atakuar gjykata ka theksuar se nga provat e administruara dhe deklaratimet e palëve ndërgjyqëse ka vërtetuar faktin se baza juridike e kërkesëpadisë nuk është kontestuese, ndërsa për vërtetimin e lartësisë së dëmit të shkaktuar sipas propozimit të palëve, është bërë nxjerrja e provës me ekspertizë të lëmisë mjekësore nga ekspertët mjekësor Dr. N.D. ortoped-traumatolog dhe dr.V.B., – R., -psikiatër, sipas të cilëve paditësja si pasojë e aksidentit

ka pësuar *lëndime të lehta trupore- përndrydhje të unazave të qafës, shtypje të krahrorit, kokës dhe unazave të mesit* të manifestuara me dhembje fizike të intensitetit posaçërisht të rëndë të cilat kanë zgjatur për 15 minuta nga momenti i aksidentit deri në dhënien e ndihmës së parë, dhembje të intensitetit të rëndë të cilat kanë zgjatur për 24 orë, për shkak të spazmit të muskulaturës, pengesave të kohë pas kohshme, dhembje të intensitetit të mesëm në kohëzgjatje prej 21 ditësh- për shkak të dhimbjeve në lëvizje të qafës dhe mesit, dhembje të intensitetit të ulët- të cilat janë prezentë edhe sot kohë pas kohe sidomos me ndryshimin e kushteve klimatike. Ka konstatuar se paditësja gjatë shërimit ka pasur nevojë për ndihmë dhe kujdesin e huaj për në kohëzgjatje prej 4 javë, ndihmë që ka konsistuar në përgatitjen e ushqimit, veshmbathja, higjiena dhe ndihma e personit të tretë dhe për ushqim të përforcuar në kohëzgjatje prej 6 javë – ushqim i pasur me vitamina, minerale, proteina- ushqim më i përforcuar se ai i zakonshmi. Dr.V.B-R., psikiatër në ekspertizën e dhënë ka konstatuar se paditësja ka përjetuar frikë primare në formë të frikës nga vdekja dhe kërcënimi i drejtpërdrejt për integritet të saj fizik, gjendje e tronditjes psiqike e cila ka zgjatur disa sekonda. Sipas ekspertës paditësja ka përjetuar frikë sekondare të intensitetit të lartë në kohëzgjatje prej 48 orë si pasojë e reaksionit emocional, stresit, e cila është përcjell me ankth dhe shqetësim, dhe ka kaluar në frikë sekondare të intensitetit të mesëm, e cila ka qenë prezentë për 6 javë e shoqëruar me pasojat e aksidentit, përjetimin e herë pas hershëm të dhimbjeve, mbajtjen e imobilizimit-qafores, e shoqëruar me ankth, zbrazje emocionale, gjumë jo të rehatshëm dhe ulje të disponimit, si dhe ka pësuar frikë të intensitetit të ulët e cila ka zgjat edhe për 1 vit e cila është manifestuar me frikë, ankth, sidomos gjatë pjesëmarrjes në komunikacion. Gjykata e shkallës së parë ekspertizave mjekësore në tërësi ua ka falur besimin pasi të njëjtat janë punuar në mënyrë profesionale dhe janë mjaftueshëm të argumentuara. Përkitazi me shpenzimet e mjekimit, gjykata e shkallës së parë ka arsyetuar se vendimin e ka bazuar në faturat kuponët fiskal të dorëzuara nga paditësja në cilësi të provës materiale. Në fund ka shtuar se nga provat e administruara dhe nga gjendja e vërtetuar faktike është vërtetuar se e paditura mban përgjegjësi për dëmin e shkaktuar paditëses dhe se e njëjta është e obliguar mbi bazën e auto përgjegjësisë që t'ia kompensoj dëmin, në kuptim të dispozitave të nenit 136, 137, 159, 169 dhe 183 të LMD-së.

Për pjesën e refuzuar të kërkesëpadisë gjykata ka arsyetuar se përtej shumës së gjykuar vlerat e kërkuara nga paditësja janë vlerësuar si tepër të larta dhe se shumat e kërkuara nga paditësja përtej shumave të gjykuara janë mbi vlerën reale të dëmit të pësuar, ndërsa kërkesën për kompensimin e dëmit për rehabilitim fizioterapeutik e ka refuzuar për arsye se pala paditëse nuk ka prezentuar ndonjë një provë për ta argumentuar dhe provuar këtë formë të dëmit.

Për kamatën gjykata ka vendosur duke u mbështetur në dispozitën e nenit 382 par.2 të LMD-së, ndërsa vendimin mbi shpenzimet e procedurës e mbështeti në dispozitat ligjore të nenit 452.2, 453 lidhur me nenin 463.1 dhe 2 të LPK-së.

Gjykata e Apelit nisur nga kjo gjendje e çështjes vlerëson se qëndrimi dhe përfundimi juridik i gjykatës së shkallës së parë është i drejtë dhe i ligjshëm, pasi që aktgjykimi i atakuar nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika (b), (g), (j), (k) dhe (m) e LPK-së dhe e drejta materiale është zbatuar në mënyrë të drejtë

për të cilat shkaqe Gjykata e Apelit kujdeset sipas detyrës zyrtare në kuptim të dispozitës së nenit 194 të LPK-së.

Gjykata e Apelit vlerëson se nuk qëndrojnë pretendimet ankimore të t'paditurës se aktgjykimi i ankimuar është përfshirë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2 pika n) të LPK-së, me pretendimin se aktgjykimi ka mungesa për shkak të cilave nuk mund të shqyrtohet, për faktin se kjo gjykatë vlerëson se aktgjykimi i atakuar është krejtësisht i qartë, dispozitivi është i kuptueshëm e po ashtu është në përputhje edhe me arsyet e aktgjykimit. Lidhur me arsyetimin e aktgjykimit, gjykata i është përmbajtur me korrektësi dispozitave që përcaktojnë strukturën dhe përmbajtjen e aktgjykimit, ndërsa në mënyrë specifike arsyetimi i aktgjykimit në vetvete paraqet një përmbajtje koherente me rrjedhë logjike edhe për gjendjen e fakteve të konstatuara nga gjykata, për provat e administruara, për vlerësimet e gjykatës lidhur me faktet dhe besueshmërinë e provave, e po ashtu edhe për kualifikimin e këtyre fakteve në raport me normat materialo-juridike. Në arsyetim gjykata e shkallës së parë ka dhënë arsye të mjaftueshme cilat nga faktet i ka vërtetuar, pse dhe si i ka vërtetuar ato fakte dhe cilat nga provat i ka shfrytëzuar për vërtetimin e fakteve të provuara, ku përmes vërtetimit të fakteve vendimtare, ka arritur që ta vërtetoj plotësisht dhe në mënyrë të drejtë gjendjen faktike, e cila ka mbështetje të plotë në shkresat lëndore dhe në ligj.

Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit nuk qëndron pretendimi ankimor i të paditurës se aktgjykimi i ankimuar është i përfshirë në konstatimin e gabuar apo jo të plotë të gjendjes faktike, ngase Gjykata e Apelit konstaton se gjykata e shkallës së parë në mënyrë të drejtë dhe të plotë e ka vërtetuar gjendjen faktike, me provat e administruara, ku baza juridike e kërkesëpadisë nuk ka qenë kontestuese, ndërsa lidhur me lartësinë e dëmit i ka administruar të gjitha provat si ekspertizat mjekësore nga lëmi i ortopedisë dhe psikiatrisë, të cilat në mënyrë të qartë dhe precize kanë sqaruar për të gjitha kategoritë e dëmit, natyrën dhe llojin e lëndimeve, intensitetin dhe kohëzgjatjen e dhimbjeve dhe frikës, nevojën për ndihmë të huaj dhe ushqim të përforcuar, të cilat ekspertiza i ka vlerësuar edhe kjo gjykatë si profesionale dhe në përputhje me provat shkresore. Poashtu për dëmin material për shpenzime të mjekimit gjykata ka vërtetuar gjendjen faktike në bazë të provave të ofruara nga paditësja siç janë kuponët fiskal.

Gjykata e Apelit vlerëson se gjykata e shkallës së parë në përputhje me gjendjen faktike të konstatuar, duke marrë në konsideratë natyrën e lëndimeve trupore të cilat i ka pësuar paditësja në aksidentin e ndodhur, e duke marrë për bazë edhe rrethanat tjera që ndikojnë në përcaktimin e lartësisë së kompensimit si intensitetin dhe kohëzgjatjen e dhimbjeve fizike dhe intensitetin, kohëzgjatjen dhe mënyrën e manifestimit të frikës, të cilat i ka pësuar paditësja në aksidentin e ndodhur, rezulton se shumica e gjykuar paditëses në emër të dëmit jo material për këto kategori të dëmit është në përputhje të plotë me qëllimin e kompensimit. Për këto kategori të dëmit jo material gjykata e shkallës së parë del të ketë vendosur në mënyrë të ekuilibruar në mes të shumës së gjykuar dhe natyrës së lëndimeve përkatësisht dëmit që ka pësuar paditësja, duke siguruar që kompensimi i gjykuar të jetë satisfaksion për paditësen duke shmangur qëllimet tjera materiale (lukrative) që mund të bien ndesh me qëllimin e satisfaksionit në raste të tilla.

Kjo gjykatë e ka vërtetuar aktgjykimin e ankimuar edhe në pjesën e gjykuar përkitazi me kompensimin e dëmit material në emër të ushqimit të përforcuar dhe ndihmës së personit të tretë, pasi sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit shumat e gjykuara nga gjykata e shkallës së parë, janë në përputhje me dëmin material i cili i është shkaktuar paditëses, pasi që në bazë të mendimit profesional të dhënë nga ekspertët mjekësor është konstatuar se paditësja ka pasur nevojë për ndihmë të huaj në kohëzgjatje prej 4 javësh, ndërsa për ushqim të përforcuar në kohëzgjatje prej 6 javë.

Nën rrethanën e tillë kjo ka rezultuar me humbje materiale për paditësen pa marrë parasysh faktin se përkujdesjen ndaj saj ka mundur ta ushtroj ndonjë familjar apo edhe person tjetër jashtë familjes së tij, i cili me kompensim është angazhuar që të përkujdeset për të njëjtën gjatë periudhës sa ka pasur nevojë për ndihmë të personit të tretë. Humbje materiale paditësja ka pasur edhe sa i përket ushqimit të përforcuar, me çka kur merret parasysh natyra e lëndimeve trupore të cilat i ka pësuar, cili lloji i ushqimit shtesë përveç ushqimit të zakonshëm çdo ditë i është nevojitur, koston e çmimeve ushqimore në Kosovë dhe praktikën e gjertanishme të gjykatave të Kosovës rreth kompensimit për këtë lloji dëmi, kësaj gjykate i ka rezultuar se shumat e gjykuara për këto kategori të dëmit material, kanë mbështetje në ligj por edhe në praktikën e gjertanishme gjyqësore.

Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, drejtë gjykata e shkallës së parë ka aplikuar të drejtën materiale edhe lidhur me dëmin material të gjykuar paditëses në emër të shpenzimeve të shërimin, pasi që kjo gjykatë me shikim në shkresa të lëndës ka konstatuar se në bazë të faturave, respektivisht kuponëve fiskal paditësja për mjekimin e saj nga pasojat e aksidentit ka shpenzuar shumën prej 65.50 Euro.

Gjendja faktike e konstatuar nga gjykata e shkallës së parë është në harmoni me të drejtën materiale për përgjegjësinë e të paditurës për ta kompensuar dëmin, e cila rrjedh nga dispozitat e nenit 136 të Ligjit mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve (Ligji nr. 04/L-077) me të cilin shprehimisht parashihet: 1). “*Kush i shkaktonte tjetrit dëm ka për detyrë ta kompensojë, përveç nëse vërtetohet se dëmi është shkaktuar pa fajin e tij*”; nenit 140 që përcakton se: “*Fajësia ekziston kur dëmtuesi e ka shkaktuar dëmin me dashje ose nga pakujdesia*”; dispozitën e nenit 159 par.1 që parasheh se: “*Në rast aksidenti të shkaktuar nga mjete motorik në lëvizje që është shkaktuar vetëm për faj të një zotëruesi zbatohen rregullat për përgjegjësinë në bazë të fajit*”, dispozitën e nenit 183 të të njëjtit ligj me të cilin përcaktohet se :1). “*Për dhembjet e pësuar fizike, për dhembjet e pësuar shpirtërore për shkak të zvogëlimit të aktivitetit jetësor, të shëmtimit, të cenimit të autoritetit, të nderit, të lirive ose të të drejtave të personalitetit, të vdekjes së personit të afërm, si dhe frikës, gjykata, po të konstatojë se rrethanat e rastit sidomos intensiteti i dhembjeve dhe i frikës dhe zgjatja e tyre e arsyetojnë këtë, do të gjykojë shpërblimin e drejtë në të holla, pavarësisht nga shpërblimi i dëmit material si dhe nga mungesa e dëmit material. 2). Me rastin e vendosjes për kërkesën për shpërblimin e dëmit jo material, si dhe për lartësinë e shpërblimit të tij, gjykata do të kujdeset për rëndësinë e cenimit të së mirës dhe të qëllimit të cilit i shërben ky shpërblim, por edhe për atë, se me te mos të favorizohen synimet që nuk janë në pajtim me natyrën e saj dhe me qëllimin shoqëror*”. Me dispozitën e nenit 169 të të njëjtit ligj përcaktohet se: 1). *Personi përgjegjës ka për detyrë ta rivendosë gjendjen e cila ka*

qenë para se të shkaktohet dëmi. 2. Në qoftë se rivendosja e gjendjes së mëparshme nuk e mënjanon plotësisht dëmin, personi përgjegjës ka për detyrë që për pjesën tjetër të dëmit të japë shpërblimin në të holla. 3. Kur rivendosja e gjendjes së mëparshme nuk është e mundur, apo kur gjykata konsideron se nuk është e domosdoshme që këtë ta bëjë personi përgjegjës, gjykata do të caktojë që ai t'ia paguajë të dëmtuarit shumën përkatëse në të holla në emër të shpërblimit të dëmit. 4. Gjykata do t'i gjykojë të dëmtuarit shpërblimin në të holla kur ai këtë e kërkon, me përjashtim kur rrethanat e rastit konkret e arsyetojnë rivendosjen e gjendjes së mëparshme.

Në kuptim të dispozitave të sipërcituara e duke u mbështetur në fakte përcaktuese të provuara me mjete provuese të besueshme raporte mjekësore dhe ekspertiza përkatëse për lartësinë e dëmit të shkaktuar (meqë baza e kërkesëpadisë nuk ishte kontestuese), rezulton se gjykata e shkallës së parë ka marr vendim të drejtë dhe të ligjshëm kur ka vendosur si në dispozitiv të aktgjykimit të ankimuar.

Gjykata e shkallës së parë drejtë ka vendosur edhe për kamatën e gjykuar, pasi që kamata del të jetë vendosur në përputhje të plotë me dispozitën e ligjit material të nenit 382 të LMD-së, pra kamata është përcaktuar në përputhshmëri me këtë dispozitivë ligjore.

I drejtë del të jetë vendimi mbi shpenzimet e procedurës i cili është në përputhje me dispozitën e nenit 452.2; 453 lidhur me nenin 463.1 dhe 2 të LPK-së dhe sa i përket lartësisë është në harmoni me tarifën e Odës së Avokatëve dhe tarifën për shpenzime gjyqësore, andaj rrjedhimisht edhe pretendimi ankimor i të paditurës për zbatim të gabuar të së drejtës materiale përkitazi me shpenzimet e procedurës është i pa bazuar.

Gjykata e Apelit me rastin e vendosjes i vlerësoi edhe të gjitha pretendimet e tjera ankimore, mirëpo të njëjtat pretendime nuk ishin me ndikim për një vendim ndryshe për çka edhe vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Aktgjykimi i ankimuar në pikën II të dispozitivit nuk është shqyrtuar nga ana e Gjykatës së Apelit për shkak se në bazë të thënieve nga ankesa kjo gjykatë ka konstatuar se aktgjykimi i ankimuar nuk është goditur në këtë pjesë.

Nga arsyet e paraqitura më lart e në pajtim me dispozitën e nenit 194, 195 paragrafi 1 pika (d), lidhur me nenin 200 të LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË

Ac.nr.4618/20 më datë 27.03.2024.

Kryetarja e kolegjit
Halide Reka d.v,